UDHËZIM
Nr.44, datë 3.11.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.19, DATË 18.7.2007 "PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 58 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 2 të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit" shtohet pika 2.1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"2.1 Institucionet e arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), listën e studentëve të regjistruar në vitin akademik përkatës, në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD), sipas afatit të përcaktuar në udhëzimin respektiv për regjistrimet. AKP brenda 1 muaji i dërgon institucioneve të arsimit të lartë, listën përkatëse të numrave të matrikullimit për çdo student."

2. Pika 13 e udhëzimit ndryshon, si më poshtë vijon:

"13. Agjencia Kombëtare e Provimeve në bashkëpunim me sektorin e statistikave në MASH përgatit Rregulloren teknike të administrimit dhe sigurisë së bazës shtetërore (kombëtare) të të dhënave të studentëve."

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj